



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BULQIZE
AUTORITETI KONTRAKTOR**

Adresa: Lagja "Minatori" Bulqizë

email.bashkia.bulqize@bulqiza.gov.al

Date: ___/___/2022

PROCESVERBAL _____

Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Hartim dokumentacioni për regjistrim fillestar të tokave bujqësore në fshatin Sopot.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Harta ,Harta kadastrale dixhitale,regjistrues te ndryshem te te dhenave,sherbim i hartave ne zonat rurale.:22114300-5:30221000-4:3164400-2:71222200-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

8.000.000 (tetëmilione) lekë pa T.V.SH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Bashkia Finiq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 12

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Sipas kritereve Te pergjithshme te pranimit/kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019,2020,2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në

rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c", të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" , ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga e data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e

mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 41 pika 3 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.3.2 Ofertuesi duhet të paraqesë licencë profesionale të vlefshme të shoqërisë në fushën e hartografisë për projektim, të lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj, si më poshtë:

- Kategoria. 8 a → Rilevime inxhinierike
- Kategoria. 8 b → Rilevime inxhinierike kadastrale
- Kategoria. 8 c → Sisteme GIS
- Kategoria. 8 d → Bazamente gjeodezike
- Kategoria. 8 e → Projektim fotogrametrik dhe hartografik

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Në bazë të liçences profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që ne kërkojmë të prokurojme dhe pikat e kërkuara të licenses janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit.

2.3.3 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka certifikimet e nevojshme dhe kapacitete të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe cilësi të kontratës, (referuar specifikave të saj), duhet që të përmbushë kushtet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 9001:2015** ose ekuivalente të saj, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të sigurisë së informacionit, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 27001:2013** ose ekuivalente të saj, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi

kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

Argumentimi: Eshte vendosur ky kriter në përputhje me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 77, pika 4 , VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“, neni 44,pika 1, si dhe natyrës së sherbimeve që do realizohen. Keto certifikata jane te lidhura me natyren dhe zerat e punimeve qe do te realizohen.

2.3.4 Kandidati/ofertuesi duhet të ketë të punësuar dhe te perfs hire ne licensen e shoqerise për ekzekutimin e kësaj kontrate:

- Inxhinier gjeodet 2 (dy)
- Inxhinier elektronik ose shkenca kompjuterike ose inxhinier informatik 1 (nje)
- Punonjës staf mbështetës 2 (dy)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve të mesiperm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ne zbatim te ndryshimeve te reja ligjore operatoret ekonomik te kualifikuar pas mbylljes se fazes se vleresimit duhet te dorezojne prane AK,perpara nisjes se afateve te ankimimit, te gjithë dokumentacionin provues si me poshte:

- Kontrata individuale e punes sipas legjislacionit në fuqi me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të kontrates për këtë objekt.
- Diplomen perkatese
- Ne zbatim te akteve ligjore, drejtuesit e mesiperm nuk duhet te figurojne te dy punesuar njekohesisht ne sektorin publik dhe privat. Per kete administratori i operatorit ekonomik duhet te paraqese deklaraten perkatese.Mosparaqitja e ketij informacioni do te konsiderohet si kusht per skualifikim. (Autoriteti Kontraktor do te verifikojë saktësinë e informacionit).
- Punonjesit e mesiperm pjese e stafit duhet detyrimisht te jene te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.5 Operatori ekonomik / ofertuesi duhet te kete nje punesim minimal prej 5 (pesë) punonjesish.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ne zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë të kualifikuar pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojnë pranë AK, përpara nisjes së afatit të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

- Listpagesat sipas formularit satandard për sigurimet.
- Vertetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur në përputhje me natyrën e shërbimit që kërkohet dhe personelin teknik të domosdoshëm për realizimin e këtij shërbimi.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Grafiku i kryerjes së shërbimeve të kerkuara.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

KOMISIONI